Në bazë të Programit për aktivitetet e Qytetit të Shkupit nga fusha e arsimit të mesëm për vitin 2026 („Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit“ nr. 14/25, 06/26 dhe 08/26), dhe nenit 3 të Rregullores për mënyrën, kushtet, kriteret dhe procedurën e ndarjes së bursave për nxënës të shkollave të mesme me aftësi të kufizuara, nxënës në shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit me nr. 08-10960/1 të datës 24.09.2026, Qyteti i Shkupit shpall këtë:

THIRRJE PUBLIKE
PËR NDARJEN E BURSAVE PËR NXËNËSIT E SHKOLLAVE TË MESME ME AFTËSI TË KUFIZUARA, NXËNËS NË SHKOLLAT E MESME TË QYTETIT TË SHKUPIT PËR VITIN SHKOLLOR 2026/2027

I. PËRSHKRIMI I THIRRJES PUBLIKE

Respektimi i diversitetit dhe avancimi i gjithë përfshirjes në procesin arsimor kanë rëndësi qendrore për arritjen e një arsimi cilësor për të gjithë nxënësit, duke përfshirë edhe ata nxënës me aftësi të kufizuara, si dhe për zhvillimin e bashkësive gjithëpërfshirëse, paqësore dhe të drejta. Prandaj, orientimi i Qytetit të Shkupit është që, me mbështetje financiare dhe logjistike, të mbështesë iniciativa të ndryshme që garantojnë të drejtën e fëmijës për arsimim bazuar në mundësi të barabarta.

Në këtë drejtim është planifikuar realizimi i projektit „Stipendimi i nxënësve të shkollave të mesme me aftësi të kufizuara“, qëllimi themelor i të cilit është ngritja e cilësisë së arsimimit të nxënësve me zhvillim atipik. Në këtë drejtim, nxënësit me aftësi të kufizuara nga shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit do të stipendohen në bazë të kushteve dhe kritereve të përcaktuara me Rregulloren për mënyrën, kushtet, kriteret dhe procedurën e ndarjes së bursave për nxënës të shkollave të mesme me aftësi të kufizuara, nxënës në shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit.

II. KUSHTET DHE KRITERET PËR NDARJEN E BURSËS

Të drejtë për bursë kanë aplikantët që ndjekin mësimin në shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit, e që i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Të jenë nxënës të shkollave të mesme me aftësi të kufizuara;
- Të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Të jenë banorë të Shkupit;
- Të jenë nxënës të rregullt në shkollë të mesme të Qytetit të Shkupit;

- Të jenë nxënës të rregullt që gjatë vitit të kaluar shkollor kanë arritur sukses minimal prej 3,00

- Të mos jenë shfrytëzues të bursës nga institucion tjetër, ndërmarrje apo organizatë tjetër në vitin shkollor 2026/2027;

- Të mos kenë përsëritur vitin gjatë
  arsimimit të tyre, përveç për arsye shëndetësore.

Kriteret për ndarjen e bursës për nxënësit me aftësi të kufizuara në shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit janë të përcaktuara në Rregulloren e cila është shtojcë e thirrjes publike.

III. LARTËSIA E BURSËS

Lartësia e bursës që Qyteti i Shkupit ua ndan nxënësve të shkollave të mesme me aftësi të kufizuara, nxënës në shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit, është 3.000 denarë në muaj (shumë neto), në kohëzgjatje prej 9 muajve, dhe i referohet vitit shkollor 2026/2027. Obligimi për llogaritjen dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat personale i takon Qytetit të Shkupit.

Mjetet financiare do të paguhen në xhirollogarinë e prindit/kujdestarit/personit tjetër të autorizuar, të dorëzuar nga aplikanti.

IV. MËNYRA E SHPALLJES SË THIRRJES PUBLIKE

Thirrja publike publikohet në faqen e internetit të Qytetit të Shkupit (www.skopje.gov.mk) dhe në mediat elektronike.

Thirrja publike do të zgjasë 10 ditë kalendarike nga dita e shpalljes.

V. MËNYRA E APLIKIMIT DHE DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM

Aplikimi në Thirrjen publike bëhet me dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtëm:

- Fletëparaqitje për stipendim të nxënësve të shkollave të mesme me aftësi të kufizuara, nxënës në shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit;

- Gjetje dhe mendim për llojin dhe shkallën e aftësisë së kufizuar në zhvillimin psikik ose fizik dhe nevojat specifike, lëshuar nga institucioni kompetent, në pajtim me Rregulloren për vlerësimin funksional, miratuar nga Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 09/23);

- Kopje e shtetësisë së aplikantit;
- Kopje e letërnjoftimit të prindit/kujdestarit/personit tjetër të autorizuar;
- Kopje e xhirollogarisë së prindit/kujdestarit/personit tjetër të autorizuar;
- Vërtetim për nxënës të rregullt në vitin shkollor 2026/2027, lëshuar nga shkolla e mesme;
- Kopje e dëftesës së vitit të kaluar shkollor të përfunduar, ku nxënësit e vitit të parë të arsimit të mesëm duhet të bashkëngjisin dëftesën e arsimit fillor të klasës së 9-të;
- Deklaratë e nënshkruar nga prindi/kujdestari/personi tjetër i autorizuar, me të cilën vërtetohet se aplikanti nuk është shfrytëzues i bursës nga institucion tjetër, ndërmarrje apo organizatë tjetër në vitin shkollor 2026/2027;
- Vërtetim nga shkolla e mesme se aplikanti nuk ka përsëritur vit shkollor gjatë arsimimit të tij, përveç për arsye shëndetësore (çka vërtetohet me dokumentacion përkatës mjekësor);
- Deklaratë për pëlqim për përpunimin e të dhënave personale.

Fletëparaqitja për stipendimin e nxënësve të shkollave të mesme me aftësi të kufizuara, nxënës në shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit për vitin shkollor 2026/2027, Deklarata me të cilën vërtetohet se aplikanti nuk është shfrytëzues i bursës nga institucion tjetër, ndërmarrje apo organizatë tjetër në vitin shkollor 2026/2027, dhe Deklarata për pëlqim për përpunimin e të dhënave personale, janë në dispozicion në ambientet e Qytetit të Shkupit, Sektori për Arsim (baraka 2), Arkivi i Qytetit të Shkupit (baraka 16) dhe në faqen e internetit të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk.

Fletëparaqitjet duhet të dorëzohen në Qytetin e Shkupit, me postë në adresën: bul. „Ilinden“ nr. 82, 1000 Shkup, ose në Arkivin e Qytetit të Shkupit (baraka 16), më së voni deri më **28.11.2026 deri** në orën 19:00 të ditës së fundit të përfundimit të Thirrjes publike, me shënimin: për **„THIRRJE PUBLIKE PËR NDARJEN E BURSAVE NXËNËSVE TË SHKOLLAVE TË MESME ME AFTËSI TË KUFIZUARA, NXËNËS NË SHKOLLAT E MESME TË QYTETIT TË SHKUPIT PËR VITIN SHKOLLOR 2026/2027“.**

Fletëparaqitjet dorëzohen në zarf të mbyllur dhe të vulosur me shënimin “Për Komisionin për zbatimin e procedurës së stipendimit të nxënësve të shkollave të mesme me aftësi të kufizuara, nxënës në shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit për vitin shkollor 2026/2027”, pa shënimin e aplikantit që e paraqet fletëparaqitjen.

Fletëparaqitjet e parregullta, që nuk janë dorëzuar në mënyrën e kërkuar në tekstin e lartpërmendur, përkatësisht që përmbajnë të dhëna të paplota dhe dokumentacion jo të plotë, si dhe ato që nuk do të dorëzohen brenda afatit të caktuar, nuk do të shqyrtohen.

VI. MËNYRA E VLERËSIMIT

Për zbatimin e kësaj Thirrjeje publike, Kryetari i Qytetit të Shkupit do të formojë Komision për zbatimin e procedurës së ndarjes së bursave për nxënës të shkollave të mesme me aftësi të kufizuara, nxënës në shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit, për vitin shkollor 2026/2027, i cili do të jetë i ngarkuar të kryejë vlerësimin e kërkesave të arritura në pajtim me Rregulloren për mënyrën, kushtet dhe procedurën e ndarjes së bursave për nxënës të shkollave të mesme me aftësi të kufizuara, nxënës në shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit, e cila është publikuar në faqen e internetit të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk.

VII. MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT TË FLETËPARAQITJEVE

Thirrja publike shpallet më 19.11.2026 dhe zgjat deri më 28.11.2026.

Vendimi për kandidatët e zgjedhur do të publikohet publikisht në faqen e internetit të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk

Informata shtesë mund të merren në telefonin 02/3297-317.

QYTETI I SHKUPIT